



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0095

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Eor Group SH.P.K.” kundër Vendimit për anulimin lidhur me aktivitetin e prokurimit të Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me gjeneratore dhe invertore” me nr. të prokurimit: "VU644-23-11221-1-2-1" me 16/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Eor Group SH.P.K.” me nr. 2024/95 , kurse vendimi i AK Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me gjeneratore dhe invertore” me nr. të prokurimit: "VU644-23-11221-1-2-1", ndërsa vendimi i AK-së te mbetet ne Fuqi.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Eor Group SH.P.K.”.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.10.2023 Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me gjeneratore dhe invertore” me nr. të prokurimit: "VU644-23-11221-1-2-1" . Ndërsa me datën 17.01.2024. ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 18,280.00 euro.

Me 22.01.2024 OE “Eor Group Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 25.01.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.02.2024 OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Eor Group Sh.P.K.” me nr. 95/24 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me gjeneratore dhe invertore” me nr. të prokurimit: "VU644-23-11221-1-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Eor Group Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Te pa kënaqur me vendimin B58 për anulim të datës 17.01.2024 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues-AK Komuna e Vushtrrisë në lidhje me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me gjeneratorë dhe invertorë “ me nr. të prokurimit: VU644-23-11221-1-2-1 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-23-149-121 në afatin ligjor konform nenit 109 të LPP-së, ushtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-se: Për shkak se AK- Komuna e Vushtrrisë: - Në mënyrë të kundërligjshme e ka anuluar procedurën e prokurimit në lidhje me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me gjeneratorë dhe invertorë “ me nr. të prokurimit: VU644-23-11221-1-2-1 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-23-149-121 pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.) dhe kemi ofertuar me Tender të përgjegjshëm me Çmimin më të ulët. Sqarojmë në mënyrë të detajuar : Autoriteti Kontraktues Komuna e Vushtrrisë me datën 17.10.2023 ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin: “Furnizim me gjeneratorë dhe invertorë “ me nr. të prokurimit: VU644- 23-11221-1-2-1 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-23-149-121 dhe me datën 07.11.2023 e kemi dorëzuar tenderin tone në platformën elektronike të e-prokurimit ku kemi aplikuar për këtë tender dhe gati pas dy muaj e gjysme AK e publikon njoftimin B58 mbi vendimin e AK-se ku e Anulon këtë tender me arsyetimin se kinse paskan gabuar në specifika teknike dhe patjetër është dashur që ta anulojnë këtë procedure të prokurimit. Konform Rregullores së KRPP-se Nr. 001-2022 neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve me konkretisht në nenin 40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës

më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve. Pra, AK brenda 30 ditëve është dashur që ta vlerësojë këtë tender ndërsa, siç po shihet nga procedura dhe arsyetimi i AK-se haptas po vërehet se AK nuk ka dashur të na shpërblejë neve me kontrate dhe e ka anuluar këtë procedure të prokurimit pasi që edhe haptas është duke lajthitur zyrtari përgjegjës i prokurimit kinse ka patur problem me sistem para hapjes së ofertave dhe tani ju është dashur AK-se gati tre muaj për të qene në dijeni se paska pasur problem me sistem para hapjes dhe pas gati tre muajve ta anuloi procedurën por të gjithë jemi në dijeni se asnjëherë nuk ka pasur problem sistemi i e-prokurimit por ka problem “sistemi i zyrtareve të AK-së” pasi që haptas po shihet që neve nuk na kanë në “sistem” dhe haptas po na dëmtojnë duke mos na shpërblyer me kontrate dhe e kanë mbajtur pezull lëndën mbi dy muaj dhe nuk kanë mundur të na eliminojnë pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e AK-se të vendosura në NJK dhe DT dhe tani AK e anulon këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se paskan vendosur specifika të caktuara por siç po shihet nga raporti i AK-se të gjithë OE-te i kanë plotësuar kërkesat e AK-se dhe specifikat dhe nuk kanë konkurruar me një markë të caktuar por me marka të ndryshme dhe i kanë plotësuar specifikat. AK në NJK dhe DT me konkretisht në faqen 16 të DT e ka parapare që: Pra sqarimi i dosjes së tenderit ka qene deri me datën 27.10.2023 dhe në E-prokurim nuk e kemi hasur asnjë Kërkesë për Informacione Shtesë apo Aneksi 5 të dorëzuar nga ndonjë AK për më tepër asnjë vendimi mbi pezullimin e aktivitetit nëse dikush ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim por edhe sikur të kishte dorëzuar ndonjë OE kërkesë për rishqyrtim atëherë në këtë fazë për specifika teknike nuk është e lejuar anulimi pasi që tani ashtu siç ka qene dosja edhe ashtu duhet të vlerësohen ofertat pasi që siç po thirret AK në nenin 62.1.pika 1.1 se: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Kjo fare nuk ka të bëjë me këtë çështje por ka të bëjë me çështje të tjera e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit. Pra për çështje që nuk mund të rregullohen edhe nëse ligji amendamentohet e jo pse AK ka vendosur specifika të caktuara pasi që patjetër AK është dashur të vendosë specifika të caktuara sepse operatorët ekonomik duhet të orientohen për të ofertuar. Anulimi i procedurës së prokurimit në këtë fazë është në kundërshtim të plotë me nenin 62 të LPP-se pasi që nuk kemi të bëjmë fare me ndryshim të ligjit për çka është thirrur AK, gjithashtu anulimi i aktivitetit të prokurimit në këtë fazë është në kundërshtim të plotë edhe me nenin Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit të Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik të KRPP-së, Ku në nenin 43.5 përcakton se, Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsytet e mëposhtme: a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre); d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/konkurruese me negociata është më pak se

3; f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP. Pra AK është arsytuar se ka patur probleme teknike ku është e përcaktuar sipas pikës k. të këtij neni, por neve nuk kemi asnjë konstatim të KRPP-se se ka patur ndonjë gabim teknik në platforme apo ka patur ndonjë problem me sistem. Gjithashtu në Nenin 43 të po kësaj rregulloreje pra tek Ndërprerja e procedurave të prokurimit të Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik të KRPP-së, në nenin 43.7 përcakton se: 43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK. Sa për dijeninë e AK-se se nëse hyjmë në internet dhe i kërkon inventarët EP 2000 atëherë kemi disa marka të ndryshme që i prodhojnë invenoret me emër të modelit EP 2000 pra nuk është vetëm një markë e caktuar me poshtë po i paraqesim disa prej tyre: Ne ankese është bashkangjitur një model i inventarit nga marka MUST. Ne ankese është një model i inventarit nga marka Behringer. Ne ankese është një model i inventarit nga marka Santak. Dhe shumë modele të tjera që janë prodhues të ndryshëm. Pra thënë shkurt se anulimi në këtë fazë i aktivitetit të prokurimit për këto arsye që i ka cekur AK. është i kundërligjshëm dhe AK haptas po donë të na dëmtoj neve drejt për se drejti në mënyrë të kundërligjshme. Neve me datën 22.01.2024 pranë AK-se kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me të gjitha këto pretendime ankimore dhe AK me datë 25.01.2024 na kthen përgjigjen lidhur me kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin, në ankese është e bashkangjitur. Siç shihet me sipër AK e pranojnë gabimin e tyre por duke na dëmtuar neve si operator i cili kemi aplikuar me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin me të ulet. Kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-se që konform dispozitave ligjore në fuqi për prokurim si të LPP-se dhe të legjisllacionit sekondar të KRPP-se ta hartoj raportin e ekspertit dhe ta rekomandoj panelin shqyrtues që ta detyroj AK-ne që AK ti respektoj dispozitat ligjore në fuqi dhe të na shpall fitues të këtij aktiviteti të prokurimit. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit edhe pas rivlerësimit të dyte nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Si dhe në pikën 2 të nenit 1 thuhet : vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Si dhe në pikën 3 të nenit 1 thuhet: kërkohet nga zyrtaret e prokurimit që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të

obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Si dhe ne piken 2 thuhet : Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, AK ne mënyrë te kundërligjshme e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit dhe ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se dhe ne kundërshtim me nenin 43 te Rregullores për prokurim publik 01/2022 te KRPP-se ku shume qarte ne nenin 43.5 dhe 43.7 te kësaj rregulloreje janë te specifikuara kushtet se kur mundet te anulohet një procedure e prokurimit pas hapjes se ofertave. Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe oferta jone është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “Eor Group” Sh.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 62, 69, LPP-së . Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP qe ta detyroj AK-ne qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi dhe ti respektoj kërkesat e veta te vendosura ne NJK dhe DT lidhur me kete aktivitetit te prokurimit dhe te nxjerr: Vendim qe te Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik “EOR GROUP” SH.P.K. ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me gjeneratorë dhe invertorë“ me nr. te prokurimit: VU644-23-11221-1-2-1 dhe me numër te brendshëm te prokurimit VU644-23-149-121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Vushtrrisë. Anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë për anulim te aktivitetit te prokurimit: “Furnizim me gjeneratorë dhe invertorë“ me nr. te prokurimit: VU644-23-11221-1-2-1 dhe me numër te brendshëm te prokurimit VU644-23-149-121 dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim : Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që "Furnizim me gjeneratorë dhe invertorë ", bazuar në procedurën e zbatuar. Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi vendimit për anulim për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike me dt. 17.01.2024, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik. Pasi që AK dhe Komisioni i vlerësimit te ofertave verson aktivitetin ne fjale qe te anuloh se gjate fazës së vlerësimit teknik të ofertave, me theks të veçantë

gjatë vlerësimit të përmbushjes të Specifikave Teknike nga Operatorët Ekonomik në këtë proces ka konstatuar se në Specifikat Teknike të saktësuar në Dosjen e Tenderit ka një lëshim teknik, nga se tek pajisja “ Inverter “ është saktësuar modeli : Power inverter gjenerator , Model Name : EP2000, MD-EP20-1012 PRO. Sipas nenit 28 paragrafi 7 i LPP-së lidhur me nenin 19.6 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik , citat : “ Përcaktimi i Specifikave Teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose markë tregtare, patent, Hoje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull e përgjithshme e ndaluar “mbarim citati. Lidhur me këtë çështje , në fazën e Njoftimit për Kontratë para hapjes së ofertave, një prej Operatorëve Ekonomik ka dorëzuar Kërkesë për Rishqyrtim pikërisht për çështje e Specifikave Teknike të saktësuar në Dosjen e Tenderit, tek pajisja “ Inverter “ ku është saktësuar modeli : Power inverter gjenerator , Model Name : EP2000, MD-EP20-1012 PRO. Autoriteti Kontraktues, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim, ka nxjerrë Vendim duke aprovuar si pjesërisht të bazuara pretendimet e parashtruara nga O.E. në Kërkesën për Rishqyrtim, me arsyetimin se një gjë e tillë e referimit në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose markë tregtare, patent, Iloje ose origjina specifike ose prodhime, është e ndaluar dhe se në esencë kjo paraqet kufizim të paarsyeshëm në konkurrencë në mes të Operatorëve Ekonomik. Më tej gjatë proceduarës së korrigjimit të Specifikave Teknike të pajisjes në fjalë, Autoriteti Kontraktues, për shkak të pengesave në funksionimin e Platformës Elektronike, nuk ka qenë në mundësi teknike që të ngritë respektivisht publikoi në Platformë korrigjimet e bëra të Specifikave Teknike të Dosjes së Tenderit dhe për rrjedhojë Operatorët Ekonomik, pa fajin e tyre, kanë përdoruar dhe kanë dorëzuar bashkangjitur me Dosjen e Tenderit dhe Specifikat Teknike me gabime, ndërsa Autoriteti Kontraktues nga ana e tij ka konstatuar se Operatorët Ekonomik nuk duhet dhe nuk mund të penalizohen për shkak të gabimit të A.K. Andaj, Autoriteti Kontraktues, në pajtim me dispozitat e nenit 62 pika 1 paragrafi 1.1. të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe Ligjin nr. 05/L-068, citat: “ për shkak se një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit “ mbarim citati, ka vendosur të anuloi këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtin, varësisht nga interesi i Njërive Kërkuese të A.K, të korrigjuar,. ta procedoi në procedurë të Ri-tenderimit. Në zbatim të nenit 7 të LPP-së, të gjithë Operatorët Ekonomik dhe ofertat duhen të trajtohen të barabarta, ndërsa sipas nenit 53 të LPP- së, të gjithë Operatorëve Ekonomik si palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit duhet ofruar informata dhe / ose dokumente të sakta. Marrë parasysh se Specifikat Teknike të korrigjuara nuk janë ngritur në Platformën e E-prokurimit edhe përkundër faktit se një kërkesë për korrigjim është bërë nga një prej O.E. të interesuar dhe, A.K. në Vendimin e tij me shkrim të ngritur dhe në Platformën e E-Prokurimit-t ka theksuar se ka ndodhur një gabim dhe se gabimi do të korrigjohet dhe do të ngritet në Platformën e E-Prokurimit-t, por që për arsye të paditura një dokument i tillë, Specifikat Teknike të përmirësuar/korrigjuara, nuk janë ngritur në Platformën e E-Prokurimit, në esencë përbën shkelje ligjore e cila patjetër se duhet korrigjuar, andaj dhe është vendosur si në këtë Vendim. Nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 - Qëllimi, nenin 6- Ekonomiciteti dhe efikasiteti, neni 7 - Barazia në trajtim/Jo diskriminimi sepse është

rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo barabartë apo diskriminuar, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 - Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 paragrafi 4 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë. Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 13.02.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 95/2024, ndërsa me datë 01.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/95 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues është Pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit, Ndërsa OE Nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Eor Group Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/95 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës: “Për këtë aktivitet, dhe pikërisht për arsyen e anulimit të aktivitetit të prokurimit (kërkesa me emër/model të një prodhuesi të caktuar), AK ka aprovuar pjesërisht një kërkesë për rishqyrtim. Në vendim të AK-së , autoriteti kontraktues kishte konstatuar se do të bëjnë korrigjimet e dosjes së tenderit duke hequr kërkesat me emër të prodhuesit/modelit. Megjithatë tani sipas arsytimit të AK-së për shkak të mos funksionimit të E-Prokurimi të njëjtin nuk kanë mund të bëjnë korrigjimet e duhura dhe ofertat janë pranuar sipas kërkesave të dosjes së fillestare (dhe të vetme) ku janë kërkuar prodhues/model specifik, e që është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së në fuqi. Mbi këtë bazë AK tani ka bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke

konstatuar se është bërë kufizim I panevojshëm I konkurrencës.”

Konstatimi i parë (I): “ Pretendimi parë dhe kryesor ankimorë sipas ankesës nr.95/2024 është se AK ka fillimisht ka tejkualuar afatet ligjore për vlerësimin dhe marrjen e vendimit si dhe vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave. AK në arsyetim të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim konstaton se anulimi është bërë për shkak kriterëve favorizuese ku është kërkuar emri i saktë i modelit dhe se për shkak të problemeve teknike dosja e korigjuar nuk është ngarkuar në E-Prokurim. Pas analizimit të ankesës 95/24, kërkesave të dosjes dhe shkresave të lëndës, fillimisht pajtohem me pretendimin e OE ankues tejkualim të afateve ligjore, ku hapja është bërë me 05.12.2023 ndërsa njoftimi i AK është publikuar me 17.1.2024. Megjithatë , sa i përket arsyeve të anulimit të aktivitetit të prokurimit, duhet të konstatojmë se vendosja e emrit/modelit të një prodhuesi të caktuar është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së neni 7 par.5 I këtij ligji. Pas parasysh rrethanat e rastit konkretë, e kemi të pamundur të detyrojmë AK-në (zyrtarin përgjegjës) të vazhdoj një procedurë dhe të nënshkruaj kontratë në një procedurë ku shkeljet dhe kufizimi I konkurrencës është konstatuar nga vet AK. Po ashtu i rekomandojmë panelit shqyrtues që ti tërhiqet vërejtja AK-së dhe personave përgjegjës që në të ardhmen të mos lejohet/vazhdohet procedura në raste kur zbulohen të meta dhe kriterë diskriminuesë në dosje të tenderit Andaj bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues Eor Group Sh.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues Eor Group Sh.P.K janë pjesërisht të bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizim me gjeneratore dhe invertore” me nr. të prokurimit: "VU644-23-11221-1-2-1".

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik te aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me gjeneratore dhe invertore” me nr. të prokurimit: "VU644-23-11221-1-2-1", të mbetet në fuqi vendimi i AK dhe anulimi i kësaj procedure është konform nenit 62 të LPP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - Eor Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: